

Data 14/07/2023

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS -PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “MBROJTJA ME PRITA MALORE E PËRROIT TË LEKEBIBAJT (MËRTURIT)- LOTI I”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PUNIME NDËRTIMI-45210000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 143,640,742 (Njëqind e dyzet e tremilion e gjashtëqind e dyzetmijë shtatëqind dyzet e dy) Lek, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor KESH sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Bazuar sa më sipër, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme.

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore,
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatë e marrjes në dorëzim / Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim
- Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikatë e marrjes në dorëzim / Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim

Shënim: Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1/A Punime gërmimi në tokë.
- N.P - 9/D Punime dhe mbrojtje lumore
- N.P - 12/A Punime të inxhinierise se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 18/A Punime topogjeodezike
- N.S - 20/A Shpime Gjeologo - Inxhinierike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë.

(Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

✚ N.P 1/A - Punime gjurmimi në tokë

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me gjurmimi në tokë për strukturat dhe gjurmimi për kanalet e tubacioneve sipas projektit të zbatimit. Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

✚ N.P 9/D – Punime për mbrojtje lumore

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me ndërtime, mirembajtje dhe ristrukturime për sistemin e rrjedhës së ujërave natyrore. Në këtë projekt zbatimi kemi të bëjmë me mbrojtjen dhe konsolidimin e strukturave anësore të përroit të Lekbibajt. Këto punime zënë një vlerë relativisht të lartë në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë D.

✚ N.P 12/A - Punime të inxhinierisë së mjedisit

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime të veçanta të shpërndara në territor dhe vlerësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme sipas projektit të zbatimit. Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

✚ N.S 18/A – Punime topogjeodezike

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me zbatimin e rivevimeve topografike, punimeve topogjeodezike që lidhen konkretisht me rrjetat mbështetëse dhe me qëndrueshmërinë e terreneve sipas projektit të zbatimit . Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

Në këtë projekt zbatimi përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e pritave malore të përroit të Lekbibajt dhe për këtë arsye është e nevojshme që të kemi një analizë gjeologjike të vazhdueshme të vendit ku do të bëhen këto punime.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi licenca/leje të lëshuara nga QKB si më poshtë:

- Licencë kategoria III.2.A (1+2) - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
- Licencë kategoria III.2.B - “Grumbullim, ruajtje/magazininim, rikuperim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”,
- Licencë kategoria III.7.A - “Shërbime profesionale në pyje dhe kullota”

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Referuar Termave të Referencës si dhe llojit të procedurës së prokurimit (*neni 39, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*), kategoritë e kërkuara janë në përputhje sipas kërkesave të specifikimeve teknike të veçanta. Punimet do të përfshijnë rehabilitimin e plotë të skarpatës së majtë të lumit Drin nga ura prej rrugës nacionale deri në bashkimin me lumin e Valbonës. Duke patur parasysh që këto punime do të kryhen në një terren me hapësirë dhe shtrirje lumore të madhe, puna duhet të kryhet në një mënyrë të tillë që nuk ka dëmtime ose ndërhyrje gjatë rrjedhja ujore, sistemeve të drenazhimit, struktura, rrugë dhe të gjithë habitatit mjedisor rreth terrenit ku do të kryhen këto punime.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023).

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa Teknike se Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës, është në përputhje me objektin e prokurimit, rëndësisë së veprës, afatit kohor, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës, shpërndarjen e objekteve dhe fronteve të punës, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm në rastin konkret të konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Numri prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës është gjykuar duke pasur parasysh të gjitha elementet e kësaj vepre, si volumi, natyra, afati i kontratës dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve në orare të caktuara sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar personelin kryesor si Drejtues teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023), stafi inxhinierik si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik,
- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Ndërtimi profili Transport,
- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Gjeodet,
- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Hidroteknik,
- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Gjeolog,
- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Mjedisi,
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik,

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë,
- CV,
- Librezë e pune

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Prezenca e inxhinierëve drejtues teknik të përfshirë në licensë, me profilet e kërkuara është domosdoshmëri për zbatimin e këtij projekti referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Konkretisht:

Për sa i takon inxhinierit të ndërtimit (profili Gjeoteknik), është kërkuar kërkuar pasi referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, është e nevojshme prezencja e inxhinierit të kërkuar, pasi të gjitha punimet do të kryhen në një vepër me reliev të vështirë dhe ky profil i kërkuar do të jetë përgjegjës për zbatimin e punimeve për strukturat mbajtëse të dheut dhe të gjitha punimet mbrojtëse që do kryhen sipas projektit të zbatimit

Për sa i takon inxhinierit ndërtim (profili Transport), është kërkuar kërkuar pasi referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, është e nevojshme prezencja e inxhinierit të ndërtimit me profil transporti sepse do të jetë përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit të rrugëve si dhe do të organizojë punimet për rrugët provizore të kantierit dhe të gjithë punimet e këtij profili sipas projektit të zbatimit.

Për sa i takon Inxhinierit Gjeodet, është kërkuar referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, është e nevojshme prezencja e Inxhinierit Gjeodet për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të zbatimit të projektit duke bërë të mundur matjet dhe rilevimet gjeodezike si dhe gjithë punimet e zbatimit të fushës gjeodezike, etj.

Për sa i takon inxhinierit hidroteknik është kërkuar bazuar në termat e referencës dhe në punimet e parashikura për tu kryer. Referuar vendodhjes së kryerjes së punimeve dhe specifikën e veçantë që ka ky projekt, ing. hidroteknik është i nevojshëm pasi punimet që do të kryhen mund të kenë impakt direkt ose indirekt në lidhje me punën e hidrocentralit dhe të gjitha punimet që kanë të bëjnë me profilin hidroteknik. Për zbatimin e strukturave ujëmbajtëse dhe të kanaleve të kullimit.

Per sa i takon inxhinierit Gjeolog, është kërkuar bazuar në termat e referencës dhe në punimet e parashikura për tu kryer. Inxhinieri Gjeolog është i nevojshëm për përgatitjen e raporteve gjeologjike të terrenit dhe të të gjithave testeve gjeologjike që do të kryhen për zbatimin e projektit.

Për sa i takon inxhinierit Mekanik është kërkuar në termat e referencës dhe në punimet e parashikuara për tu kryer. Inxhinieri Mekanik është i nevojshëm për sigurimin dhe mbarëvajtjen sa më mirë të të gjitha makinerive që do të punojnë për zbatimin e këtij projekti me sukses.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023), stafin mbështetës si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Pyjesh

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit mbështetës inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Konkretisht:

- ✚ *Për sa i takon* inxhinierit të ndërtimit me profil (gjeoteknik), është kërkuar kërkuar pasi është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të nëntokes sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* inxhinierit gjeodet, është kërkuar pasi është i nevojshem për ndjekjen e punimeve të rilevimit dhe matjeve gjeodezike sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* inxhinierit hidroteknik, është kërkuar pasi është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit sidomos punimeve të tubacioneve, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* inxhinierit te pyjeve është kërkuar pasi është i nevojshem për mbarëvajtjen e punimeve që kane të bëjnë me mbrojtjen e pyjeve dhe vleresimit të ndikimit ne mjedis pasi punimet për zbatimin e këtij projekti do të bëhen kryesisht në zona ku ka pyje.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHT ose nga institucione ekuivalente me të si më poshtë:

- ✚ minimalisht 2 (dy) teknik ndërtimi
- ✚ minimalisht 3(tre) teknik topograf,

- ✚ minimalisht 5 (pesë) eskavatorist,
- ✚ minimalisht 2 (dy) manovrator për buldozerë
- ✚ minimalisht 8 (tetë) shofer për kamiona
- ✚ minimalisht 3 (tre) automakinist
- ✚ minimalisht 10 (dhjetë) hekurthyes
- ✚ minimalisht 5 (pesë) saldator
- ✚ minimalisht 10 (dhjetë) karpentier

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik
- Dëshmi aftësie profesionale / patenta për manovratorët dhe shoferët.
- Dëshmi kualifikimi profesional /çertifikatë/diplomë të lëshuar nga institucionet kompetente “*për arsimin dhe forminin profesional*”.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Për sa i takon stafit të kërkuar në këtë kriter, janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve që do të kryhen duke marrë parasysh shtrirjen e madhe dhe të terrenit të zbatimit dhe relievin e vështirë ku do punohet.

Konkretisht:

- ✚ *Për sa i takon* teknikut të ndertimit, është kërkuar kërkuar pasi është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të nëntokes sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* teknikut topograf, është kërkuar pasi është i nevojshem për ndjekjen e punimeve të rilevimit dhe matjeve gjeodezike sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* eskavatoristit, është kërkuar pasi është i nevojshem për operimin e punimeve të gërmimit dhe mbushjeve të materialeve të ndyshme, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* manovratorit të buldozerit është kërkuar pasi është i nevojshem për operimin e buldozerit që do të përdoret për largimin e dherave dhe ngjeshjen e tyre sipas zërave të preventivit të punimeve

- ✚ *Për sa i takon* shoferit për kamion është kërkuar pasi është i nevojshëm për transportimin e materialeve të ndryshme që do të përdoren për zbatimin e projektit sipas zërave të preventivit.
- ✚ *Për sa i takon* automakinistit është kërkuar pasi është i nevojshëm për operimin e makinerive që do të përdoren për zbatimin me sukses të projektit sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* hekurthyesit është kërkuar pasi është i nevojshëm për realizimin e punimeve të hekurit sipas zërave të preventivit të punimeve
- ✚ *Per sa i takon* saldatorit është kërkuar pasi është i nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimit sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Per sa i takon* karpentierit është kërkuar pasi është i nevojshëm për zbatimin e punimeve të hekurit dhe betonit dhe realizimin e armaturave që duhen sipas zërave të preventivit të punimeve

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023) minimalisht 3(tre) punonjës të trajnuar /çertifikuar për punime në lartësi nga të cilët minimalisht 1(një) të jetë inxhinier:

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Çertifikatë trajnimi për “Punime në lartësi D.P.I skela, shkallë, skarpate , Rënia nga lërtësitë, Punime në lartësi D.P.I skela, shkallë, skarpate etj”. Çertifikatat duhet të jenë të lëshuar nga organizma certifikimi të akredituar shqiptar ose të huaj.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Konkretisht:

Për sa i takon 3 punonjësve për punime në lartësi janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të këtij projekti duke patur parasysh që terreni ku do te punohet është i thyer dhe me skarpata të lartësive të ndryshme

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023) minimalisht 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikatë per “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë” në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Çertifikatë kualifikimi

Argumentimi:

Për sa i takon punonjësit i pajisur me çertifikatë për “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. *Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.*

Operatorët ekonomikë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të kenë kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentet përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktoj me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt. Drejtuesi teknik duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, të jetë inxhinier ndërtimi dhe të ketë me eksperiencë minimale 10 vjet. Deklarata duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë
- CV

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” e ndryshuar me ligjin nr.120/2020 “Per disa ndryshime dhe

shtesa” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të përcaktojnë Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt..

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon minimalisht 1(një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar.

Shëmin: Nëse OE nuk ka në stafin e tij mjek të përgjithshëm mund ta sigurojë atë me anë të kontratë me persona apo subjekte të specializuara për këtë shërbim.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë
- Licencë përkatëse për ushtrimin e profesionit

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në VKM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: 2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001 : 2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë

2.3.13 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar ose marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, për artikullin **Gabion me rrjetë teli**.

Autorizimi /marrëveshja duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesve ose distributorëve të autorizuar për artikullin **Gabion me rrjetë teli**, është një dokument i rëndësishëm, i cili rrit sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të rëndësisë së veçantë të gabionave që do të përdoret në funksion të realizimit të zërave përkatës referuar preventivit të punimeve që parashikon projekti objekt kontrate.

2.3.14 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët teknik për artikullin **Gabion me rrjetë teli**, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të parashikuara.

Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të parashikuara në këtë projekt.

2.3.15 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me zinxhirë dhe krahë te gjate min 15m	Cope	1	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me zinxhire kovë 0.5m ³ + Cekic	Cope	3	Në pronësi ose me qera
3	Martel Pneumatic tip sonde me fuqi 35 kW per thermim shkemi	Cope	2	Në pronësi ose me qera
4	Trencher për germim ne shkemb me fuqi 240 HP	Cope	1	Në pronësi ose me qera
5	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimum 10 – 20 Ton.	Cope	4	Në pronësi ose me qera
6	Kamionçina 3.5 – 5 Ton	Cope	4	Në pronësi ose me qera
7	Terheqes + Rimorkiator per mjete te renda kapacitet min 25 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
8	Buldozere ≥ 150Hp	Copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Autovinc me kapacitet mbajtes 3.5 – 7 Ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
10	Minifadromë	Cope	1	Në pronësi ose me qera
11	Rrul me gunga me gunga kapacitet 10 – 13 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
12	Rrul gome – hekur min 18 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
13	Kulle per ndricim kantieri	Cope	1	Në pronësi ose me qera
14	Gjenerator 200 KVA	Cope	2	Në pronësi ose me qera
15	Pomp Uji me kapacitet min 10 kW	Cope	3	Në pronësi ose me qera
16	Autobetoniere Vetengarkuese me kapacitet 2.5 m ³ – 5 m ³	Cope	3	Në pronësi ose me qera
17	Autobetoniere pompe	Cope	2	Në pronësi ose me qera
18	Kompresor me depozite ajri 1500Ltr	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	GPS + Total station me certifikate kalibrimi te Vlefshe	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Impiant Betoni	Cope	1	Në pronësi ose me qera
21	Set laboratorik per testimin e betonit, gureve dhe llojeve te ndryshme te dherave sipas Direktivave europiane(2006/42/CE , 2014/35/UE , 2014/30/UE/ , BS 1377:2 , BS6576 + Certifikate konformiteti)	Copë	1	Në pronësi ose me qera

“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore;

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Për mjetet që transportojnë mjete të rënda duhet të paraqitet çertifikata përkatëse e lëshuar nga institucioni kompetent i transportit rrugor.

-Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

-Për sejcilin mjet të deklaruar duhet të paraqiten edhe fotot përkatëse ku të jetë lehtësisht e dallueshe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.

Njësia e prokurimit